



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 106, datë 30.09.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.76, DATË 28.06.2021 PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, DURRËS, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për pallatin Kastrati, rruga “Ramadan Veliu”, pallati nr.458, rruga “Bajram Tusha” si dhe pallati nr. 1062, rruga “26 Nëntori”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetrarës së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e proçesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar

nga ky komision, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.76, datë 28.06.2021 përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.458, rruga “Bajram Tusha”, Durrës i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.2, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.76, datë 28.06.2021 të z. Fatos Boci, si përfitues nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit nr.458, rruga “Bajram Tusha”, Durrës, në masën 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 01.10.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Durrës, më 24. 09.2021



RELACION

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” si dhe Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetares së Bashkisë Durrës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim ankesën e z. Fatos Tefik Boci, banues në pallatin 458, lagjja 14, Rruga “Bajram Tusha” Shkozet, Durrës.

Z. Fatos Boci nuk është përfshirë në listën e të kualifikuarve nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 76 datë 28.06.2021, me arsyen se kjo pasuri nuk ishte e regjistruar në regjistrin hipotekor, por vetëm në sistem dhe kartela e pasurisë ishte në emër tjetër.

Në vijim subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës nëpërmjet ankesës me nr. 8231 prot., datë 09.07.2021, duke kërkuar të përfitojë banesën nga Programi i Procesit të Rindërtimit. Ankesa u depozitua pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me datë 01.09.2021.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në shqyrtimin e ankesës vëren se në dosjen e aplikantit janë këto dokumenta:

Formular Aplikimi për të përfituar nga Programi i Rindërtimit

Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. Pas., 4/14+1-4 ZK 8516, me sipërfaqe 76.00m<sup>2</sup>, aktualisht në pronësi të subjektit Fatos Boci, lëshuar me datë 28.04.2021.

Harta Treguese e Regjistrimit.

Certifikatë familjare me përbërje prej 4 personash e datës 23.02.2021.

Vërtetim nga Qendra Administrative nr.5, ku vërtetohet se Fatos Boci është banor i lagjes nr.14, Rruga “Bajram Tusha”, Pallati nr. 458.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit sqarojmë se struktura përkatëse e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike edhe si Komisioni i Posaçëm për mos përfshirjen në listën e përfituesve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak 76, datë. 28.06.2021, të ankimuesit i janë referuar mungesës së konfirmimit të pasurisë. Kjo e vërtetuar nga komunikimi që ka patur ndërmjet Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me shkresën nr. 8231/1 datë 20.09.2021 dhe përgjigjes nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike nëpërmjet shkresës nr. 8231/2 Prot datë 23.09.2021 sipas së cilës: *Bazuar në shkresën kthim përgjigje të DVASHK Durrës me numër 1807/1 prot, datë 04.03.2021 protokolluar pranë nesh me nr. 2323/1 prot, datë 04.03.2021, subjekti Fatos Boci nuk është përfshirë në listën e familjeve përfituese të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore pasi pasuria nuk është konfirmuar. Kjo pasuri nuk ishte regjistruar në regjistrin hipotekor por vetëm në sistem. Kartela e pasurisë është në emër tjetër.*

Aktualisht subjekti ankimues ka palikuar për lëshimin e certifikatës së pronësisë dhe e ka regjistruar pronën.

Sa më sipër në gjykimin tonë ankimuesi i plotëson kushtet të klasifikohet si përfitues nga programi i rindërtimit.

Lidhur me këtë situatë jemi të mendimit që ankimuesi z. Fatos Boci duhet të jetë në listën e përfituesve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021 duke u klasifikuar si përfitues referuar përsëri VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendim i cili klasifikon strukturën përfituese të banesës sipas pikës 20.1 dhe tabelës A sipas përbërjes familjare duke mbajtur në vëmendje edhe Aktin Normativ sipas së cilit neni 21 pika 2 citon: *përfitues të njëjësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njëjësive të banimit të objekteve të shembura.....struktura e njësisë së banimit që do ti kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur.*

Pra në përfundim të këtij arsyetimi referuar edhe VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” në pikën 5 përcaktohet se: “Aplikim paraqitet drejtëpërdrejtë në strukturën/at përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose në zyrën e qëndrimit më një ndalesë të njësisë...”

Si edhe pika 8 që citon:

“Kërkesat e plotësuar me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistroheshin sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacione që mundëson përpunimin e të dhënave si më poshtë vijon:

- a. Emrin, atësinë, mbiemrin
- b. Numrin e kërkesës
- c. Datën e dorëzimit, paraqitjes së aplikimit,
- d. Objektivin e kërkesës,
- e. Adresën e kërkuarit
- f. Përbërjen familjare në momentin e kërkesës
- g. Dokumentacionin e pronësisë ose cdo akt për fitimin e pronësisë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mendon të propozojë për miratim klasifikimin si përfitues i ankimesit z. Fatos Boci në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1.

Sa më sipër propozohet që kjo praktikë të kalohet Këshillit Bashkiak Durrës, i cili pas një trajtimi të rastit të gjykojë dhe vlerësojë mbi ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak 76, datë 28.06.2021 duke shtuar përfshirjen e z. Fatos Boci në listën e përfituesve në masën 2+1.

Sqarojmë se propozimi i miratuar mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

#### KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

ARBEN ISAKU

ARDJAN ILJAZAJ

ERMAL LAMA



114

REKRETA RIA  
SHKIA DURRËS  
Nr. 763 / prot.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Durrës, më 11.10.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.106 datë 30.09.2021 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.76, datë 28.06.2021 përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.458, rruga “Bajram Tusha”, Durrës, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

